



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.301/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN/IKS, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Petrit Kryeziu, jurist i diplomuar, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Prizren, të cilët i përfaqëson Gani Koci, jurist i diplomuar, për shkak të vendosjes se posterve, gjatë heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur në prani të përfaqësuesve të palëve në procedurë, me datë 13.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet si e bazuar** ankesa e BIRN/IKS, me seli në Prishtinë, kështu që koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Prizren, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,200.00 (njëmijë e dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimin të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarrimit.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën e paraqitur nga BIRN/IKS, me datë 12.06.2017, me të cilën pretendon se gjatë ditës së votimit, monitoruesi i tyre ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkangjitur si dëshmi fotografitë e printuara nga vendi i ngjarjes. Parashtruesi në ankesës po ashtu në seancën dëgjimore të datës 13.06.2017, mbetet në tërësi pranë pretendimeve ankimore, duke theksuar se me datën 11.06.2017, aktivisti i tyre ka vërejtur se posteri i kandidatit për deputet Enver Hoxhaj, nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, ka qenë i vendosur në shtyllën mbajtëse të rrethojës së shkollës “Gjon Buzuku”, në Prizren dhe se në të njëjtën shkollë ka qenë qendra e votimit 2005a. Parashtruesi i ankesës gjatë seancës propozoj që të dilet në vend të ngjarjes me qëllim të vërtetimit të faktit nëse fotografia ka qenë e vendosur në rrethojën e shkollës si dhe largësinë nga hyrja e vendvotimit.

Në përgjigjen në ankesë koalicioni PDK-AAK-NISMA, të datës 13.06.2017, si dhe në seancën dëgjimore të mbajtur me datën 13.06.2017, kanë theksuar se dëshmitë nuk janë të sakta për vetë faktin se ankuesi nuk përcakton distancën siç është përcaktuar me ligj, po ashtu nga fotografitë nuk mund të shohim nëse objekti është objekt i shkollës, dhe se ankesa është e pasafatshme sepse shkelja është evidentuar në ditën e zgjedhjeve ndërsa ankesa është ushtruar me datë 12.06.2017, në orën 16.30. Përfaqësuesi i koalicionit njëherit ka kundërshtuar propozimin për daljen në vendin e ngjarjes.

Paneli i PZAP-it, në këtë çështje juridike me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike shqyrtoi pretendimet e palëve në procedurë dhe provat si në vijim: shikoj një fotografi të printuar në formatin A4, bardh e zi nga portali Kallxo.com si dhe një fotografi në formatin A4, bardh e zi.

Pasi që paneli, bëri vlerësimin e pohimeve të palëve në procedurë, vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 117 par. 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), nga të njëjtat vërtetohet faktin e pretenduar si në parashtrimet e ankesës se posterit i kandidatit për deputet Enver Hoxhaj, nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA, ka qenë i vendosur në shtyllën mbajtëse të rrethojës së shkollës “Gjon Buzuku”, në Prizren, ky fakt është vërtetuar nga fotografit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ndonëse nga fotografimi i posterit të kandidatit Enver Hoxhaj, nuk shihet emërtimi i objektit, që pretendohet se është Qendër e Votimit por nga fotografia e posterit të kandidatit për deputet Qerim Bajram nga radhët e subjektit politik VAKAT, nga e cila shihet qartë se është fjala Shkollën Filllore “Gjon Buzuku”, në Prizren, ndërsa nga krahasimi i të dy fotove vërtetohet se është i njëjti objekt shkollor dhe e njëjta rrethojë, i cili objekt në ditën e votimit është shfrytëzuar si Qendër e Votimit, andaj e **pranoj si të bazuar ankesën** dhe vendosi si në dispozitiv duke marrë parasysh arsyet në vijim për shqiptimin e lartësisë së gjobës.

Paneli nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se posterit i kandidatit për deputet nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA, ka qenë i vendosur në shtyllën mbajtëse të rrethojës së shkollës “Gjon Buzuku”, në Prizren, gjatë heshtjes zgjedhore, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 301/2017 më datën 13.06.2017



**Kryesuesi i Panelit**  
**Fejzullah Rexhepi**

***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme, në afat prej 24 orëve nga momenti i pranimit të njëjtit.***